

ZHVILLIMI GJITHËPËRFSHIRËS EKONOMIK

DEKLARATË VJETORE E PROGRAMIT NR. I DVP-së: APS-2023-01

PYETJE TË SHPESHTA

Pyetje: Kur do të shpallet thirrja për grante?

Përgjigje: Thirrja për grante do të shpallet atëherë kur CDF/IEEA harton dhe publikon thirrjen për mbështetje financiare (APS-2023-01) në faqen e internetit të CDF në <https://kcdf.org/> dhe në faqen e CDF në Facebook në <https://www.facebook.com/CommunityDevelopmentFund>.

Pyetje: Cila është shuma maksimale që një NMVM me të drejtë aplikimi mund të përfitojë?

Përgjigje: Mbështetja financiare mund të arrij deri në 10,000 USD.

Pyetje: Kush mund të aplikojë për këtë thirrje?

Përgjigje: Të drejtë aplikimi kanë NMVM-të e regjistruara ligjërisht në pronësi të grave dhe në pronësi pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Kosovë.

Pyetje: A mundet një NMVM të jetë edhe në pronësi të grave dhe në pronësi të komuniteteve pakicë?

Përgjigje: Po, NMVM-të me mbi 1 vit ekzistencë që janë në pronësi të grave dhe në pronësi të komuniteteve pakicë dhe të cilat janë të regjistruara ligjërisht në Kosovë kanë të drejtë të aplikojnë.

Pyetje: Cili është procesi për të aplikuar për grant?

Përgjigje: Procesi për të aplikuar për grant është si në vijim:

- Aplikuesi paraqet një Shprehje të Interesit (ShI) - Koncept Dokument
- Komiteti i Përzgjedhjes së Granteve i CDF/IEEA shqyrton Shprehjen e Interesit (ShI)
- Në rast se ShI vlerësohet e suksesshme, aplikuesi duhet të dorëzojë Aplikacionin e Plotë për Grant (APG)
- Komiteti i Përzgjedhjes së Granteve i CDF/IEEA vlerëson APG-në dhe Buxhetin
- Nëse aplikimi është i suksesshëm, CDF/IEEA dhe Aplikuesi lidhin një marrëveshje për zbatim të grantit (subjekt i miratimit të USAID-it).
- Zbatimi i Aktivitetit të Grantit
- Mbyllja/Përfundimi i Grantit

Pyetje: *Cilat janë kërkesat fillestare për t'u kualifikuar për aplikim në këtë thirrje?*

Përgjigje: Aplikuesit e kualifikuar duhet të jenë NMVM të regjistruara ligjërisht në pronësi të grave ose në pronësi të komuniteteve pakicë në Kosovë të cilat mund të demonstrojnë aftësi për të kontribuar në objektivat e projektit IEEA dhe për të përmbushur qëllimet e grantit në përputhje me politikat dhe praktikën e USAID dhe CDF. Ato gjithashtu duhet të shfaqin një formë të menaxhimit të shëndoshë financiar, administrativ dhe teknik në formën e një sistemi kontrollësh që mbron asetet dhe që mbron nga mashtrimi dhe shpërdorimi. Për më tepër, ato duhet të mbështesin arritjen e objektivave të grantit dhe të kenë të kaluar të kënaqshme të performancës dhe të dhëna të integritetit dhe etikës së të bërit biznes.

Pyetje: *Cilat janë objektivat e IEEA?*

Përgjigje: IEEA synon të fuqizojë dhe ringjallë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në pronësi të grave dhe në pronësi të komuniteteve pakicë të cilët janë prekur negativisht nga pandemia e shkaktuar nga Covid-19. Përmes kësaj thirrje synohen qasje teknike kreative dhe metodologji të cilat mund të mbështesin këto objektiva.

Pyetje: *Çka nënkuptojmë me Shprehje të Interesit (ShI)/Koncept Dokumentin?*

Përgjigje: Gjatë fazës së parë, nga aplikuesit kërkohet që të paraqesin një Shprehje të Interesit (ShI)/Koncept Dokument, duke bërë një deklaratë përmbledhëse të problemit që synojnë të trajtojnë, lidhjen e aktiviteteve të propozuara me qëllimet e Zhvillimit Gjithëpërfshirës Ekonomik të Kosovës, përshkrimin e aktiviteteve dhe detyrave kryesore të propozuara, rezultatet e pritshme, duke përfshirë një plan të menaxhimit, përvojën e mëparshme të aplikuesit si dhe një buxhet të propozuar fillestar. Të gjitha shprehjet e interesit duhet të dorëzohen në formatin e bashkëngjitur në Shtojcën 1 të kësaj thirrje dhe nuk duhet të përmbajnë më shumë se 5 faqe. Shprehjet e interesit mund t'i dorëzohen CDF/IEEA-së në çdo kohë përpara datës dhe afatit të fundit të mbylles siç specifikohet në këtë thirrje. Megjithatë, inkurajohen aplikimet e hershme.

Pyetje: *Cili është dallimi në mes të fazës së paraqitjes së koncept dokumentit dhe fazës së aplikimit të plotë?*

Përgjigje: ShI duhet të shpjegojë qartë dhe në mënyrë koncize qëllimin, rëndësinë, aktivitetet dhe rezultatet e pritshme të aktivitetit të grantit të propozuar në mbështetje të objektivave të Zhvillimit Gjithëpërfshirës Ekonomik të Kosovës.

Nëse ShI rezulton e suksesshme, aplikuesi do të ftohet të dorëzojë Aplikacionin e Plotë për Grant (APG) ku duhet të paraqesë informacione më të detajuara mbi aktivitetin e propozuar të grantit. APG-ja duhet të përfshijë një përshkrim të detajuar të aktiviteteve të propozuara, një afat kohor të zbatimit, një buxhet të detajuar dhe një plan monitorimi dhe vlerësimi. APG-ja do të vlerësohet sipas një sërë kriteresh që do të përfshijnë qëndrueshmërinë dhe potencialin e rritjes së biznesit, inovacionin dhe veçantinë e aktiviteteve të propozuara, ndikimin social dhe mjedisor, si dhe ekipin dhe aftësitë e menaxhimit. Si përmbledhje, faza e paraqitjes së koncept dokumentit është faza paraprake ku aplikuesit paraqesin një përmbledhje të shkurtër të aktivitetit të tyre të propozuar të grantit, ndërsa faza e aplikimit të plotë është periudha gjatë së cilës aplikuesit e suksesshëm nga faza e paraqitjes së koncept dokumentit ftohen të paraqesin aplikacionin e plotë për grant, duke ofruar mes tjerash një përshkrim më të detajuar e të plotë të aktiviteteve të tyre të propozuara dhe një buxhet të detajuar.

Pyetje: Cili është afati i fundit për dorëzimin e ShI?

Përgjigje: Data e mbylljes së afatit për dorëzimin e ShI-së është **8 shtator 2023**, në orën 16:00, të kohës lokale në Kosovë (Koha e Evropës Qendrore). Është e rëndësishme të theksohet se kjo është një deklaratë vjetore, që do të thotë se bizneset mund të aplikojnë gjatë gjithë vitit në çdo kohë deri në afatin e caktuar. Aplikimet mund të dorëzohen në IEEA në çdo kohë përpara datës dhe kohës së mbylljes së afatit, siç specifikohet në këtë thirrje, megjithatë inkurajohen aplikimet e hershme. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se ShI-të e dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh në këtë thirrje.

Pyetje: A mundet një biznes me të drejtë aplikimi i cili është refuzuar një herë të aplikojë sërish gjatë periudhës kur DVP-ja do të jetë e hapur?

Përgjigje: Po, bizneset me të drejtë aplikimi që janë refuzuar një herë mund të aplikojnë sërish gjatë periudhës kur DVP-ja do të jetë e hapur. Kjo është një deklaratë vjetore, që do të thotë se bizneset mund të aplikojnë gjatë gjithë vitit në çdo kohë deri në afatin e caktuar. CDF/IEEA do të mbledhë një Komitet Përzgjedhës të Granteve (KPG) i cili do të vlerësojë ShI-të e paraqitura në përgjigje të kësaj mundësie financimi në baza të rregullta. ShI-të do të vlerësohen në bazë të kriterëve të përcaktuara në dokumentin e thirrjes. Nëse ShI e një aplikuesi nuk pranohet, ata mund të aplikojnë përsëri gjatë periudhës kur DVP-ja do të jetë e hapur.

Pyetje: Si mund ta paraqesë ShI-në time?

Përgjigje: Aplikacionet mund të dorëzohen në tri gjuhë (anglisht, shqip dhe serbisht). Aplikuesit duhet të dorëzojnë formularin e shprehjes së interesit me shkrim në Departamentin e Granteve të IEEA në mënyrë elektronike, përmes postës elektronike në grants@kcdf.org ose përmes kopjeve fizike në ambientet e zyrave të CDF/IEEA në adresën: rr. Sejdi Kryeziu 32, Prishtinë, Kosovë. E gjithë korrespondenca e dërguar përmes postës elektronike dhe/ose përmes kopjeve fizike duhet të përfshijë numrin e thirrjes që i referohet Zhvillimit Gjithëpërfshirës Ekonomik të Kosovës: APS-2023-01 IEEA.

Pyetje: Si do të vlerësohen ShI-të?

Përgjigje: CDF/IEEA do të mbledhë një Komitet Përzgjedhës të Granteve (KPG) i cili do të vlerësojë ShI-të e paraqitura në përgjigje të kësaj mundësie financimi në baza të rregullta.

Pyetje: Çfarë ndodh pasi një Aplikacion i Plotë i Grantit rezulton i suksesshëm?

Përgjigje: Pasi KPG të vlerësojë aplikacionin(et) të suksesshëm(e), Aktiviteti CDF/IEEA do të kryejë një analizë rreziku për të përcaktuar përgjegjësinë e para-dhënies së grantit(ëve). Kjo do të përfshijë rekomandimin për dhënie të grantit duke konfirmuar se aplikuesi:

- a) Ka burime të mjaftueshme financiare ose aftësi për të përfituar burimet financiare siç kërkohet për periudhën e zbatimit të grantit.
- b) Mund të plotësojë kushtet e grantit, duke marrë parasysh të gjitha obligimet ekzistuese të përfituesit të mundshëm.
- c) Ka të kaluar të kënaqshme të performancës.
- d) Ka të kaluar të kënaqshme të integritetit të të bërit biznes.
- e) Është i kualifikuar për të përfituar grant sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Bazuar në vlerësimin e aplikacioneve nga KPG, Udhëheqësi i IEEA do të ndajë rezultatet te zyrta/ja përgjegjes të USAID-it për miratim.

Pasi një aplikacion për grant rezulton i suksesshëm dhe miratohet nga USAID, CDF/IEEA dhe aplikuesi lidhin një marrëveshje për zbatim të grantit, dhe përfituesi i grantit ndërmerr aktivitetet e parapare të grantit siç përcaktohen në marrëveshje. CDF/IEEA do të monitorojë zbatimin e objektivave të grantit dhe rezultatet e arritura. Pas përfundimit të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe arritjes së rezultateve të pritshme sipas marrëveshjes së grantit, CDF/IEEA do të vërtetoj se granti është zbatuar me sukses.

Pyetje: A mund t'i blej unë pajisjet?

Përgjigje: Blerja e pajisjeve do të bëhet nga CDF duke ndjekur procedurat e brendshme të prokurimit të CDF. Pas përfundimit të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe arritjes së rezultateve të pritshme, CDF/IEEA do të vërtetoj se granti është zbatuar me sukses. Projekti do të disponojë dhe do të transferojë të gjitha pajisjet e blera nën grantin për përfituesin e grantit në fund të periudhës së ekzekutimit të grantit pas ekzaminimit të kriterëve për rishpërndarjen e pajisjeve.

Pyetje: A ka ndonjë preferencë të sektorit biznesor për mundësinë e përfitimit të grantit?

Përgjigje: Jo, nuk ka asnjë preferencë të indonjë sektori biznesor për këtë mundësi të përfitimit të grantit. NMVM-të me të drejtë aplikimi nga çdo sektor biznesor mund të aplikojnë për sa kohë që plotësojnë kërkesat e pranueshmërisë dhe mund të kontribuojnë në përmbushjen e objektivave të projektit IEEA.

Pyetje: Cilat janë kriteret e vlerësimit për mundësinë e përfitimit të grantit?

Përgjigje: Aplikacionet e pranueshme do të vlerësohen bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Qëndrueshmëria e biznesit dhe potenciali i rritjes
- Inovacioni dhe unikaliteti (veçantia e aktiviteteve)
- Ndikimi social dhe mjedisor
- Ekipi menaxhues dhe aftësitë

Aplikacionet që plotësojnë kërkesat e pranueshmërisë dhe marrin pikët më të larta kundrejt këtyre kriterëve të vlerësimit do të konsiderohen për përfitim të grantit.

Pyetje: A është e detyrueshme ndarja e kostos (bashkëfinancimi)?

Përgjigje: Ndarja e kostos (bashkëfinancimi) i referohet mjeteve financiare me të cilat një përfitues i grantit kontribuon në koston totale të aktivitetit të grantit dhe bëhet kusht për dhënien e grantit kur përfshihet në buxhetin e miratuar të grantit. Ndarja e kostos (bashkëfinancimi) inkurajohet, por nuk është e detyrueshme dhe nuk do të paraqesë asnjë përparësi gjatë procesit të vlerësimit. Për më tepër, ndarja e kostos (bashkëfinancimi) konsiderohet zgjidhje opsionale dhe nuk do të ndikojë në procesin e vlerësimit.